

MODELI I STATUTIT TË KOMITETIT TË AUDITIMIT

Hyrje

Ky model i statutit të Komitetit të Auditimit kap shumicën e praktikave më të mira, bashkëkohore Evropiane dhe të Amerikës Veriore. Asnjë model statuti nuk mund të përmbledh të gjitha aktivitetet që do të mund të ishin adekuate për një komitet të caktuar të auditimit, e as aktivitetet e inkuorporuara në modelin e statutit, nuk do të jenë relevante për secilin komitet. Prandaj, ky model statuti mund të i përshtatet rrethanave të secilës organizatë të sektorit publik.

Vëreni që ky model është përfaqësues i Termeve të Referimit për Komitetet e Auditimit në vendet ku funksioni i auditimit të brendshëm dhe qeverisja e përgjithshme si dhe mjedisi i kontrollit janë mirë të zhvilluara. Si pasojë, këto mund të kenë aspirime të larta, dhe pjesë të përmbajtjes mund të mos jenë të zbatueshme në një afat të shkurtë në entitet e sektorit publik të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Përbërja

Qëllimi

Për të përkrahur Ministrin (në rast të ministrisë në qeverinë qendrore apo organet relevante) ose Kuvendin Komunal (në rast të qeverisë lokale) në adresimin e përgjegjësive të tyre për rrezikun, kontrollin dhe qeverisjen, dhe aktivitetet e ndërlidhura të sigurimit. Në mënyrë specifike, kjo përfshinë asistimin e Ministrisë apo Kuvendit Komunal në përmbushjen e përgjegjësive të tyre për:

- Integritetin e pasqyrave financiare;
- Pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullatore;
- Kontrollin e brendshëm të financave publike;
- Menaxhimin e rrezikut;
- Efikasitetin dhe objektivitetin e funksioneve të auditimit të brendshëm; dhe
- Performancën e funksionit të auditimit të brendshëm dhe auditorëve të jashtëm.

Autoriteti

Ligji mbi Auditimin e Brendshëm i jep Komitetit të Auditimit autoritetin dhe përgjegjësin që të:

- Sigurojnë se menaxhmenti i lartë dhe personeli i entiteteve të sektorit publik zbatojnë me kohë rekomandimet e bëra nga Njësia për auditimin e brendshëm (Neni 5.4 i LAB);
- Kërkojnë apo lejojnë që Njësia për auditim të brendshëm të vlerësojë shkallën deri në të cilën janë zbatuar rekomandimet e mëparshme dhe shkallën e ndonjë përmirësimi që ka rezultuar (Nenet 4.5 (d) dhe 5.4 të LAB);
- Raportojnë të gjitha instancat e ndonjë dyshimi për shkelje ligjore tek autoritetet publike përkatëse (Neni 5.4 (c) i LAB);
- Sigurojnë që Njësia për auditim të brendshëm është e pavarur dhe e lirë nga ndërhyrja e menaxhmentit të operacioneve të cilat auditohen (Neni 5.5 i LAB (a));

- Hetojnë ndonjë ndërhyrje të pretenduar, refuzim apo rezistim të aktiviteteve të ligjshme të auditimit të brendshëm dhe përnjëherë të ndreqin atë sjellje përfshirë suspendimin, largimin apo marrjen e veprimeve të tjera disiplinore ndaj personit në fjalë (Neni 5.5 (b) i LAB);
- Kërkojnë që NJAB të dorëzojë planet e auditimit për miratim (Nenet 4.7, 5.2 të LAB)
- Mbikëqyrin Njësia e auditimit të brendshëm në zhvillimin dhe ekzekutimin e planeve të saj strategjike dhe vjetore (Neni 5.2 i LAB);
- Kërkojnë nga Njësia e auditimit të brendshëm të dorëzojë raportet lidhur me pajtueshmërinë dhe sistemet e kontrollit si edhe rekomandimet që rezultojnë nga aktivitetet e auditimit të brendshëm (Nenet 4.5, 13.2 (f) të LAB);
- Kërkojnë nga Njësia e auditimit të brendshëm të dorëzojë raportet vjetore lidhur me aktivitetet e auditimit të Njesisë së auditimit të brendshëm (Neni 13.2 (g) i LAB); dhe të
- Mbajnë të gjitha dokumentet në lidhje me secilin auditim, sikur edhe ndonjë auditim të suspenduar (Neni 4.6 i LAB).

Anëtarësimi

- Anëtarët e Komitetit të Auditimit janë:
 - Anëtarë i brendshëm jo – ekzekutiv: *listoj ata, së bashku me datën e përfundimit ose përtëritjes*
 - Anëtarë i jashtëm: *listoj ata, së bashku me datën për përfundimit ose përtëritjes*
 - Anëtarë të tjerë: *listoj ata, së bashku me datën për përfundimin ose përtëritjes*
- Komitetit i Auditimit do të kryesohet nga: *shkruani emrin*
- Funkcionet sekretariate do të ofrohen nga: *shkruani emrin*

Mbledhjet

- Komitetit i Auditimit do të takohen më së paku katër (4) herë në vit. Kryesuesi i Komitetit të Auditimit mund të thërras mbledhje shtesë sipas nevojës.
- Më së paku 50% (gjysma) e anëtarëve të Komitetit të Auditimit duhet të jenë të pranishëm që mbledhja të jetë e vlefshme.
- ZKA, ZKF, Drejtori, Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe përfaqësuesi i Zyrës së Auditorit Gjeneral mund të ftohen që të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit të Auditimit.
- Komiteti i Auditimit mund të ftoj zyrtarë të tjerë të organizatës që të marrin pjesë, që të ndihmojnë me diskutime në ndonjë çështje.
- Komiteti i Auditimit mund të kërkojë nga ndonjëri apo nga të gjithë që normalisht ndjekin mbledhjen por që nuk janë anëtarë, të tërhiqen nga mbledhja në çfarëdo kohe që të lehtësojnë diskutimet e hapura për çështjet e caktuara.

- ZKA-të ose Ministrat mund të kërkojnë nga Komiteti i Auditimit që të thërras mbledhje tjera për të diskutuar çështjet e caktuara për të cilat kërkojnë këshilla nga komiteti.

Qasja në Komitetet e Auditimit

Drejtori, Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe Ministri ose Kuvendi Komunal do të kenë qasje të lirë dhe konfidenciale te Kryesuesi i Komitetit të Auditimit.

Raportimi

- Komiteti i Auditimit do të raportoj zyrtarisht me shkrim ZKA-së pas çdo mbledhje për të adresuar çështjet që do të paraqiten për sa i përket:
 - cilësisë dhe integriteti të pasqyrave financiare;
 - pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret dhe
 - performancës dhe pavarësisë të Njesisë për Auditimin e Brendshëm
- Komiteti i Auditimit do të përgatis Raportin Vjetor për Ministrin ose Kuvendin Komunal ku përshkruhet përbërja e komitetit, përgjegjësitë dhe si kryhen ato, si dhe informatat e tjera relevante, përfshirë edhe rishikimin e nivelit të lartë të përshtatshmërisë dhe pranueshmërisë së:
 - Procesit për vlerësimin e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut, kontrollin e brendshëm dhe përgjegjësinë;
 - Politikat e kontabilitetit;
 - Pasqyrat financiare;
 - Efikasitetin e auditimit të brendshëm dhe jashtëm; dhe
 - Përgjigjen e menaxhmentit për sa i përket çështjeve të identifikuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe auditori i jashtëm (nëpërmjet të Letrës së Menaxhmentit)

Përgjegjësitë

Komiteti i Auditimit është përgjegjës që të ofroj mbikëqyrje në fushat e mëposhtme:

Pasqyrat Financiare

- Ku organizata përgatit pasqyra financiare sipas ligjit, rishiko pasqyrat për kualifikim. Merrni parasysh çështjet e rëndësishme të politikave të kontabilitetit dhe raportimit si dhe ndikimin e tyre në deklaratat financiare para se të prezantohen deklaratat para auditorëve të jashtëm. Çështjet kyçe që duhet të merren parasysh janë:
 - Transaksionet komplekse apo të pazakonshme;
 - Artikuj kontabiliteti me gjykim të lartë;
 - Çështjet kryesore për sa i përket parimeve të kontabilitetit dhe prezantimit të pasqyrave financiare, përfshirë çfarëdo ndërrimi të rëndësishëm në zgjedhjen apo aplikimin e politikave të kontabilitetit dhe
 - Ndikimin e iniciativave rregullatore ose të kontabilitetit, dhe strukturat që janë jashtë bilancit në pasqyrat financiare.

- Pas auditimit sipas ligjit, rishikoni me menaxhmentin dhe auditorët e jashtëm rezultatet e auditimit, ndonjë vështirësi që keni hasur dhe të gjeturat. Kjo përfshinë rishikimin e çfarëdo kufizimi të venë në fushën e aktiviteteve të auditimit ose qasjen në informatat e kërkuara, dhe ndonjë mosmarrëveshje të rëndësishme në mes të auditorëve dhe menaxhmentit. Diskutoj pasqyrat financiare me menaxhmentin dhe drejtorin e auditimit.
- Takohet me auditorët e jashtëm siç nevojitet për të diskutuar çfarëdo çështje që komiteti ose auditorët besojnë që duhet të diskutohet privatisht.

Pajtueshmëria

- Rishikimi i të gjeturave të auditorëve, mendimet, dhe rekomandimet që kanë të bëjnë me sistemet e organizatës për sigurimin e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret.
- Rishikimi i të gjeturave të ekzaminimeve nga ana e agjencive rregullatore dhe auditorëve.

Kontrolli i Brendshëm

- Merrni parasysh efikasitetin e mjedisit të kontrollit të brendshëm, përfshirë edhe kontrollin e teknologjisë informative dhe sigurisë.
- Kuptoni fushën e rishikimit të kontrollit të brendshëm nga ana e auditorëve të brendshëm dhe jashtëm dhe siguron raporte mbi të gjeturat dhe rekomandimet e rëndësishme, së bashku me përgjigjet e menaxhmentit.

Menaxhimi i Rrezikut

Diskutoj me menaxhmentit politikat kryesore për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut.

Funksioni i Auditimit të Brendshëm

- Rishiko me menaxhmentin dhe Drejtorin, statutin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, planet strategjike dhe vjetore, aktivitetet, punësimin e personelit dhe strukturën organizative të funksionit të auditimit të brendshëm.
- Siguro që nuk ka kufizime apo limitime në aktivitetet e auditimit të brendshëm
- Rishiko dhe pajtohu në emërimin, zëvendësimin apo shkarkimin e Drejtorit, Njesisë së Auditimit të Brendshëm.
- Merr parasysh raportin vjetor, të gjeturat dhe rekomandimet dhe përmbledhjen e aktiviteteve aktuale dhe të propozuara të auditimit dhe nivelin e sigurisë që ofron ajo
- Merrni parasysh përmbledhjet e auditimeve të brendshme specifike siç kërkohet
- Konsideroni raportet prej Njesisë së Auditimit të Brendshëm që identifikon kufizimet në fushë ose qasje, dhe identifikoni rekomandimet e dakorduara që nuk janë zbatuar në kohën e arsyeshme.
- Auditimet speciale ose hetimet e komisionit
- Raportimi i mashtrimit potencial apo praktikave të korrupsionit të autoritetet e caktuara.
- Takimi me Drejtorin, Njesisë e Auditimit të Brendshëm sa herë që duhet për të diskutuar çështjet e ndjeshme.

Performanca e Auditorëve të Brendshëm dhe Jashtëm

- Rishikimi i fushës së propozuar dhe qasjes së auditorëve të jashtëm, përfshirë koordinimin e përpjekjeve të auditimit me auditimin e brendshëm.
- Rishikimi i performancës së auditorëve të jashtëm, duke marrë parasysh mendimet e menaxhmentit dhe Drejtorit, Njesisë së Auditimit të brendshëm .
- Rishikimi i efikasitetit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, përfshirë pajtueshmërinë me standardet relevante profesionale dhe duke pasur kujdes ndaj mendimeve të menaxhmentit dhe auditorit të jashtëm
- Rishikimi i efikasitetit të raporteve të auditimit të brendshëm dhe rekomandimeve me menaxhmentin dhe ofrimi i informatave kthyesë të auditimi i brendshëm

Të tjera

- Rishikimi dhe vlerësimi i përshtatshmërisë së Statutit të Komitetit të Auditimit
- Konfirmimi një herë në vit që të gjitha përgjegjësitë e parashtruara në këtë Statut janë plotësuar
- Vlerësimi i performancës së komitetit dhe anëtarëve individual në komitet çdo vit.

Kërkesat për informacione

Për të përmbushur obligimet e tija, Komitetit të Auditimit duhet t'i ofrohet informacioni i mëposhtëm, i plotësuar sipas nevojës:

- Vlerësimi i rrezikut nga ZKA-ja;
- Raporti mbi progresin nga Drejtori, Njësia e auditimit të Brendshëm që përmbledhë;
- Punën e kryer krahasuar me punën e planifikuar;
- Çështjet kyçe që dalin nga puna e auditimit të brendshëm;
- Përgjigjja e menaxhmentit nga rekomandimeve të auditimit;
- Ndërrimet ndaj Planit Vjetor të Auditimit;
- Ndonjë burim, fushë apo vlerësim i çështjeve që ndikojnë në arritjen e objektivave të auditimit;
- Raporti mbi progresin nga Zyra e Auditorit Gjeneral;
- Strategjia mbi Auditimin e Brendshëm;
- Plani Vjetor i Auditimit të Brendshëm;
- Raportet dhe opinionet nga Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm;
- Raportet për sigurimin e cilësisë, për sa i përket funksionit të auditimit të brendshëm;
- Draft pasqyrat financiare dhe shënimet;
- Raportet mbi çfarëdo ndryshimi në politikën e llogaridhënies;
- Letrën për Menaxhmentin nga Zyra e Auditorit Gjeneral;
- Raporti mbi bashkëpunimin në mes të Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Zyrës së Auditorit Gjeneral;